



**Kanton Zürich  
Bildungsdirektion  
Volksschulamt**

# **Shkolla popullore në Kantonin e Cyrihut**

**Informacione për  
prindërit**

Për fëmijët dhe të rinjtë shkolla është pjesë përcaktuese e përditshmërisë së tyre. Ajo plotëson edukimin në familje. Në shkollë fëmija Juaj krijon përvoja të shumanshme dhe të vlefshme mësimore dhe jetësore. Të gjithë të rejtat dhe të rinjtë kanë të drejtën e arsimimit. Ata ndjekin kopshtin e fëmijëve dhe shkollën në vendbanimin e tyre pa pagesë.

Ju si prind përkatësisht si i autorizuar për edukim përkrahni shkollën, personelin mësimor dhe autoritetet shkollore në mënyrë që këta të mund ta kryejnë detyrën e tyre. Ata punojnë dhe janë përgjegjës së bashku për fëmijët dhe të rinjtë. Përmes informacioneve të përhershme reciproke dhe bisedave të përbashkëta kujdesen për atë që fëmija Juaj të marrë përkrahjen e duhur për një shkollim të mirë.


### **Kërkesat dhe qëllimet e shkollës**

Shkolla publike popullore e Kantonit të Cyrihut ju përmbahet parimeve bazë të shtetit demokratik. Ajo është neutrale në aspektin fetar dhe politik. Njohuritë themelore mbi vlerat e krishtera, humane dhe demokratike janë të rëndësishme për një nxënës për njohjen më të mirë të kulturës dhe të shoqërisë sonë. Liria Juaj religjioze dhe ajo e fëmijës ruhen vazhdimisht.

Gjatë shkollimit të obliguar fëmija dhe të rinjtë e Juaj përvetësojnë dhe zhvillojnë njohuritë dhe shkathtësitë themelore. Ata përgatiten për shkollim të mëtejshëm. Shkolla popullore kujdeset për atë që të zhvillojë ndjenjën e marrjes parasysht të njerëzve dhe të ambientit përreth. Përmes kësaj fëmijët dhe të rinjtë Tuaj të zhvillohen në njerëz të pavarur dhe të përgjegjshëm dhe që janë në gjendje të zënë vendin e tyre në shoqëri.

Shkollimi i obliguar zgjat zakonisht 11 vjet. Obligimi shkollor mund të përmbushet edhe në shkollë private apo përmes mësimit privat (Homeschooling).

## Pasqyrë e shkollimit populor të Kantonit të Cyrihut



### **Fillimi i shkollimit**

Nëse fëmija Juaj bëhet 4 vjeç deri më 31 korrik, ai fillon me kopsht në vendbanimin e tij në vitin e ri shkollor. Me caktimin në njërën prej kopshteve merret Këshilli Shkollor.

### **Viti shkollor**

Viti shkollor fillon në mesin e gushtit dhe përfundon në mesin e korrikut të vitit tjetër. Fëmija Juaj ka gjithsej 13 javë pushim gjatë një viti shkollor. Pushimet e vjeshtës, të kërshtëndellave, pushimet e sportit dhe to verore janë të shpërndara gjatë tërë vitit shkollor.

### **Një ditë shkollore**



Mësimi apo përkujdesja bëhet nga e hëna deri në të premten nga ora 8 deri në ora 12.00 (koha bllok). Pasditeve klasë klasat e ndryshme kanë orare individuale. Si prind jeni të obliguar që fëmijën ta dërgoni me kohë në mësim dhe ai ta ndjekë atë sipas orarit mësimor. Komunitat ofrojnë struktura ditore për përkujdesje për fëmijët. Këto oferta janë zakonisht me pagesë.

### **Kopshti i fëmijëve**



Dy vitet e para fëmija Juaj i kalon në kopsht të fëmijëve. Në këto dy vite ai përkrahet në mënyrë të shumanshme në zhvillimin e tij. Në mësimin në kopsht flitet dialekt (gjermanishte zvicerane).

### **Shkolla fillore zgjat gjashtë vjet**



Me gjashtë vjet fëmija Juaj pranohet në shkollën fillore. Të gjithë fëmijët e ndjekin mësimin bashkërisht pavarësisht prejardhjes, gjinisë dhe rezultateve të tyre në mësim. Sipas rregullit, mësimdhënësi përgjegjës i klasës ndërrohet pas tre vjetësh. Me këtë rast edhe klasa kombinohet ndryshe.

Në shkollën fillore fëmija Juaj përvetëson, zgjeron dhe përforcon aftësitë e tij në të lexuar, në të shkruar dhe në llogaritje. Në shkollën fillore mësohet arti figurativ, muzika, edukata fizike dhe sporti, natyra, njeriu, shoqëria dhe religjioni, kultura, etika si dhe mediumet dhe informatika.

Që nga klasa e dytë fëmija Juaj merr dy herë në vit dëftesë shkollore. Dëftesa jep edhe informacione mbi rezultatet në mësim dhe mbi qëndrimin ndaj punës dhe mësimi si dhe mbi qëndrimin social të tij.

Fëmijët, të cilët në zhvillimin e tyre intelektual apo personal kanë nevojë për ndihmë, e marrin këtë përmes masave të veçanta përkrahëse pedagogjike. Në këtë bën pjesë edhe përkrahja për të talentuarit. Se cilat masa janë të nevojshme vendos Këshilli Shkollor zakonisht me pajtimin e prindërve.

Pas gjashtë viteve të shkollimit fillor, fëmija Juaj kalon në shkollën sekundare. Nëse fëmija Juaj tregon rezultate mbi mesatare në matematikë dhe gjermanisht, mund të lajmërohet për gjimnaz. Aty pranohet pas dhënies së provimit pranues. Me këtë ai e lëshon shkollën fillore dhe i kalon tri vitet e mbetura të shkollimit të obliguar në gjimnaz.

### **Shkolla sekundare tri vjeçare ndahet në dy apo tri drejtime**



Në shkollën sekundare fëmija Juaj thellon dhe zgjeron njohuritë dhe aftësitë e tij të fituara në shkollën primare. Veç të tjerash mësohen edhe lëndët si natyra dhe teknika, dhe ekonomia, puna, amvisëria. Shkolla sekundare përgatit fëmijën Tuaj për mësimin e një profesioni apo në shkolla për arsimim të mëtejshëm. Në mënyrë që të rinjtë të përkrahen në mënyrë optimale, komunat ofrojnë dy (A,B) apo tri drejtime (A, B apo C). Drejtimi A është me kërkesat më të larta. Në disa prej lëndëve, komunat mund të vendosin edhe shkallë të ndryshme kërkesash I, II apo III. Shkalla I është me kërkesat më të larta, shkalla III e kërkesave është me kërkesat më të ulëta.

### **Pas shkollës popullore**

Pas përfundimit të vitit të tretë të shkollës sekundare, të rinjtë kanë dy rrugë të mundshme për arsimim të mëtejshëm: shkollimin profesional (shkollimin bazë profesional) apo shkollimin e mesëm (gjimnazin). Rreth dy të tretat e të rinjve absolutojnë një shkollim profesional dy, tre apo katër vjeçar. Nëse fëmija Juaj interesohet për profesione me kërkesa të larta, mund të arrijë maturën në ndonjë gjimnaz, shkollë profesionale me maturë, në ndonjë shkollë të mesme të tregtisë dhe të informatikës apo në ndonjë shkollë të mesme të profilizuar. Maturat janë: matura e gjimnazit, e shkollës profesionale apo e shkollës së profilizuar me maturë. Të tri maturat i mundësojnë fëmijës Tuaj studim në një shkollë të lartë (të profilizuar). Ndjekja e rrugëve të mëtejshme të shkollimit është e mundur edhe gjatë jetës së mëtejshme profesionale. Për të gjitha rrugët profesionale të rinjtë e rritur kanë oferta të shumta në dispozicion.

## **Shkolla popullore publike dhe shërbimet e saj Vendi i shkollës dhe rruga për në shkollë**

Fëmija Juaj ndjek mësimin në vendbanimin e tij. Këshilli shkollor i vendbanimit përcakton se së cilën shkollë do ta ndjekë fëmija Juaj mësimin. Udhëheqja e shkollës vendos pastaj se në cilën klasë do të ndjeke mësimin fëmija Juaj. Rrugën për në shkollë dhe anasjelltas fëmija Juaj e bën parimisht vetë. Në rrugë për në shkollë dhe anasjelltas fëmija Juaj mbledh përvoja të ndryshme sociale: e zbulon botën përreth, vendos kontakte sociale me fëmijët e tjerë dhe zhvillon hap pas hapi personalitetin e tij.

## **Kohët e mësimit (kohët bllok) dhe struktura ditore**

Koha e mësimit apo ajo e përkujdesjes paradite zgjat nga ora 8.00 deri në ora 12.00. Këshilli Shkollor mund ta shkurtojë kohën e përkujdesjes për shkaqe organizative për më së shumti 20 minuta. Kohën e drekës dhe mësimin pasdite, komunat e rregullojnë në mënyra të ndryshme. Koha e drekues duhet të jetë mjaftueshme aq sa t'i mundësojë fëmijës Tuaj marrjen e një racioni dhe kthimin me kohë në shkollë. Komunat ofrojnë kohët e përkujdesjes (paradite, në mesditë dhe pasdite) dhe nga ora 7.30 deri ne ora 18.00 vënë në dispozicion ofertën e tyre. Ofertat e përkujdesjes jashtë orarit bllok janë me pagesë.

## **Përkrahjet e veçanta**

Parimisht, fëmija Juaj ndjek mësimin në klasën e rregullt, edhe pse mund të ketë nevojë për përkrahje në fusha të caktuara. Nëse fëmija Juaj ka njohuri të pamjaftueshme të gjermanishtes, vështirësi në të mësuar apo ndonjë kufizim tjetër, do të përkrahjet në mënyrë plotëse nga persona të caktuar profesionistë. Fëmija Juaj ka të drejtën e shanseve të barabarta në mësim dhe për t'u përkrahur si duhet aty ku ka nevojë. Përveç mësimit të rregullt, fëmija Juaj ka në dispozicion edhe oferta të ndryshme përkrahjeje: përkrahje integruese, terapi (psiko-motorikë, logopedi, psikoterapi, audio-pedagogji), gjermanishtja si gjuhë e dytë, mësimi sipas dëshirës në gjuhën dhe kulturën amtare, shkollim të posaçëm të integruar, shkollim në spitale dhe në klinika si dhe, në disa komuna të veçanta, edhe përkrahja për të talentuarit dhe klasë të veçanta (klasat e përgatitjes për shkollim, klasat e vogla apo ato pranuese). Zakonisht fëmija Juaj do t'i ketë këto orë përkrahëse brenda orarit të rregullt mësimor; në rast e është e nevojshme edhe jashtë orarit të rregullt.



### **Shëndeti**

Shëndeti psikik dhe fizik i fëmijës Tuaj është i rëndësishëm. Shërbimi mjekësor i shkollës, profilaksia dentare, shërbimi psikologjik shkollor si dhe shërbimi për punë sociale i shkollës ofrojnë masa për përkrahjen e shëndetit në shkollën popullore. Të gjithë fëmijët kontrollohen nga mjeku dhe nga mjeku i dhëmbëve. Këto kontrole janë të obligueshme. Po ashtu edhe lëvizja e mjaftueshme dhe një ushqim i balancuar janë vendimtarë për një zhvillim të shëndetshëm të fëmijëve dhe të të rinjve Tuaj. Shkolla ju informon mbi temat që kanë të bëjnë me shëndetin në mësim. Veç kësaj, shkollat mund të angazhojnë edhe persona të jashtëm profesionistë, si për shembull për edukim në komunikacion, për përkrahje në lëvizje dhe për pedagogjinë seksuale.

### **Prindërit dhe shkolla popullore**

Arsimimi dhe edukimi i nxënësve dhe nxënësve janë detyrë e përbashkët e shkollës dhe e prindërve. Një parakusht i rëndësishëm për sukses në mësim i fëmijëve është bashkëpunimi i mirë në trekëndëshin shkollë – prindër-nxënëse apo nxënës.

Shkolla ju njofton Ju si prind rregullisht mbi sjelljet dhe suksesin e fëmijëve Tuaj. Shkolla siguron edhe bashkëpunimin e prindërve në mbrëmjet e klasës së prindërve, në javët e projekteve të shkollës, në ditët e vizitave në shkollë, në dekorimin e vendit për kalimin e pauzës etj. Kjo pjesëmarrje e përgjithshme për Ju si prind nuk është e obligueshme. Në raste të caktuara Komisioni Shkollor apo udhëheqja e shkollës mund ta shpallë ndonjë takim me prindërit si të obligueshëm. Si prind nuk keni të drejtë vendosjeje në përcaktimin e personelit apo në çështjet metodike-didaktike.

Si prind jeni i obliguar për edukimin e fëmijës Tuaj si dhe për ardhjen e tij të rregullt në mësim si dhe për përmbushjen e detyrimit të tij shkollor. Ju e informoni personelin mësimor apo udhëheqjen e shkollës mbi sjelljen e fëmijës Tuaj dhe mbi ndodhitë në rrethin e tij për aq sa kjo ka rëndësi për mbarëvajtjen e tij në shkollë. Vendimet e rëndësishme, sidomos ato që kanë të bëjnë me karrierën shkollore, shkolla i bisedon menjëherë me Ju si prind dhe me fëmijën Tuaj. Si prind Ju kujdeseni po ashtu për atë që fëmija Juaj të ketë veshjet dhe pajisjet adekuate. Fëmija Juaj si nxënëse apo si nxënës përmbush të gjitha obligimet e saj apo të tij dhe merr pjesë aktive në jetën shkollore. Në shkollën popullore fëmijët kanë të drejtë pjesëmarrjeje dhe vendosjeje në pajtim me moshën e tyre. Ata nuk marrin pjesë në vendimet që merren për ta, vetëm në rast se atë s'ua lejon moshja apo ka arsye të tjera që flasin kundër kësaj.



### **Çka të bëhet në rast vështirësish?**

Personeli mësimor dhe prindërit informohen menjëherë reciprokisht. Për Ju si prind., kujdestarja apo kujdestari i klasës së fëmijës Tuaj janë personi i parë kontaktues. Nëse nuk arrini që problemet t'i zgjidhni në bisedë me kujdestarin e klasës, drejtohu tek udhëheqja e shkollës. Nëse as aty nuk gjeni zgjidhje, merrni kontakt me autoritetet lokale shkollë apo me Këshillin lokal Shkollor.

### **Rreth shkollës**

#### **Dispenzimi**

Në rast të mungesave paraprakisht të njohura, bëni si prind kërkesë për dispenzim udhëheqjes së shkollës.. Shkolla e dispenzon fëmijën nga mësimi, në rast se për këtë ka arsye të duhura apo për këtë flasin rrethanat personale, familjare apo rrethanat shkollë.



#### **Ditët xhokerë**

Gjatë vitit shkollor fëmija Juaj ka të drejtë që pa ndonjë arsye të mungojë dy ditë në mësim. Marrjen e këtyre ditëve xhokerë Ju si prind duhet t'ia bëni paraprakisht me dije shkollës.

#### **Pushimet**

Në Kantonin e Cyrihut pushimet zgjasin më së shumti 13 javë gjatë një viti shkollor. Veç kësaj, komunat shkollë mund të caktojnë edhe më së shumti katër ditë të tjera të lira. Shpesh këto ditë bien në festat lokale si karnavalet apo «Chilbi». Zgjedhje e ditëve nuk guxon të bëhet ashtu që të çojë te java e 14-të e pushimit.

#### **Vlerësimi kompetent dhe dëftesat**

Personeli mësimor e vlerëson rregullisht fëmijën Tuaj për rezultatet në lëndë të caktuara si dhe për zhvillimin e tij në mësim dhe për sjelljet e tij në kuadër të bashkësisë së klasës. Se si e vlerëson mësuesja apo mësuesi fëmijën Tuaj në kopsht dhe në klasën e parë dhe të dytë kuptoni nga dy bisedat që bëhen gjatë vitit shkollor me Ju si prind. Në vitet tjera, fëmija Juaj merr dëftesën me nota në janar dhe në korrik në fund të vitit shkollor. Me rastin e kalimit nga shkolla primare në atë sekundare, kujdestari i klasës zhvillon me Ju si prind dhe me fëmijën Tuaj një bisedë mbi kalimin në ciklin e lartë.

### **Kush mund t'ju japë informacione prindërve?**

Kontaktojeni si prind së pari kujdestarin e klasës së fëmijës Tuaj. Informacione mbi shërbimet, mbi vendet e ndryshme të informimit dhe mbi shërbimet e tjera mund të informoheni më së miri në komunën shkollore apo edhe në ueb-faqen e komunës Tuaj. Komunitat shkollore kanë faqet e tyre të internetit. Faqet e internetit të shkollave kanë informacione të bollshme për Ju.

### **Informacione të tjera**

Informacione të plota mbi numrat e rëndësishëm të telefonit dhe të shërbimeve të tjera gjenden në ueb-faqen e Drejtorisë së Arsimit dhe të Entit të Shkollimit Popullor.

[www.zh.ch/volksschule](http://www.zh.ch/volksschule)

[www.zh.ch/bildungsdirektion](http://www.zh.ch/bildungsdirektion)

**Bildungsdirektion, Volksschulamt**

**Walchestrasse 21, 8090 Zürich**

**Telefon 043 259 22 51**